



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:031197

Datë: 11.10.2024

Numri i dokumentit: 06288986

KF.nr.403/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Giga Group” ShPK me NUI 811184035 dhe seli në rr. “Mulla Idrizi” në Gjilan, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit – rivlerësim tatimor, vlera e kontestit 51,376.50 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, të mbajtur me datë 04.10.2024 në prani pronarit të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Eset Berisha, avokat nga Prishtina, e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Giga Group” ShPK me seli në Gjilan.
- II. ANULOHET vendimi nr.389/2020 i datës 15.12.2020, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës dhe lënda në këtë pjesë kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë dhe plotësimin e saj, me datë 03.08.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me

të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.339/2020 të datës 15.12.2020 si dhe raportin e kontrollit të datës 30.09.2020. Në seancë gjyqësore përfaqësuesi i autorizuar i paditësi ka deklaruar se sipas raporti të kontrollit financiar të kryer nga e paditura e i cili kontestohet nga paditësi, figuron se shuma e saktë e borxhit tatimor është 86,131.86€. Duke marrë parasysh këtë raport e paditura ka ekzekutuar shumën direkt nga llogaria e paditësit duke mos e njoftuar fare paditësin madje duke i sekuestruar edhe kreditë e tij nga një donacion i Bankës Botërore. Tutje deklaroi se raporti përfundimtar i të paditurës përbën në vetë gabime në kalkulim, pasaktësi të ngarkimit të tatimit dhe një pjesë edhe ngarkim me tatim mbi bazën e së cilës nuk lejohet sipas ligjit, pasi që në raportin përfundimtar nuk janë marrë parasysh fare bartjet e humbjeve prej vitit 2014-2015, tatimi në fitim prej 16,977.20€ nuk korrespondon me faturimet dhe pagesat bankare të cilat janë ofruar si prova bashkë me padinë, nuk janë marrë parasysh investimet në vlerë prej 84,992.08€, nuk është pranuar si tatim i zbritshëm shuma prej 12,000.00€, dhe në fund huadhëniet nga vetë paditësi janë llogaritur si të hyra të tatueshme. Tutje deklaroi se si rrjedhojë e këtij raporti të kontrollit financiar, shuma e përgjithshme e cila është marrë nga e paditura është mbi pagesë nga vlera e mjeteve financiare që duhet kthyer e që është 73,368.80€, pasi që vlera e vërtetë e borxhit ndaj të paditurës është 12,763.06€. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se e ka pranuar ekspertizën financiare dhe ndaj të njëjtës nuk ka vërejtje. E precizon kërkesëpadinë e paditësit si në vijim: aprovohet kërkesëpadija si e bazuar, anulohet vendimi me nr.389/2020 i datës 15.12.2020 i DA, vërtetohet shuma e inkasuar nga e paditura në vlerë prej 77,623.38€ paraqet shumën e inkasuar më tepër se sa obligimet shtesë për pagesë të paditësit, rrjedhimisht detyrohet e paditura që këtë shumë së bashku me normën e interesit ligjorë prej 8% t'ia kthejë paditësit në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit. Shpenzimet e procedurës gjyqësore i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 01.04.2022 i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura të paditësit si të pabazuara në ligj dhe fakte materiale dhe vlerëson se vendimi i kundërshtuar është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Tutje deklaroi se kontrolli tatimor gjatë vlerësimit të tij është bazuar në librat e blerjes dhe shitjes dhe llogaritë bankare të cilat i ka ofruar paditësi. Duke u bazuar në këto prova ka konstatuar se paditësi si blerje investive ka evidentuar shumën prej 17,000.00€, stoku i datës 31.12.2014 ka qenë në vlerë prej 74,867.22€, andaj kontrollin e ka filluar nga kjo bazë fillestare. Paditësi në periudhën e TVSH-së 08/2015 ka deklaruar blerje investive në vlerë prej 73,000.00€ pa TVSH, por kjo blerje nuk është dokumentuar me faturë tatimore e cila është paraparë me dispozita ligjore. Në periudhën 11/2015 ka deklaruar TVSH në importe në vlerë prej

40,000.00€ pa TVSH, por ky import nuk është argumentuar me DUD dhe as me veprime tjera doganore. Po ashtu në vitin 2016 paditësi ka pasur parregullsi në mbajtjen e evidencës në KMSH dhe në shpenzime operative dhe nuk ka mundur që të bëjë argumentimin e tyre. Andaj për këtë arsye nga ana e ATK-së është bërë pranimi i pjesshëm i KMSH-së. Tutje ATK i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të merr aktgjykim me të cilin refuzohet si e pabazuar padia dhe kërkesëpadija e paditësit “Giga Group” ShPK dhe të mbetet në fuqi Vendimi i Administratës Tatimore të Kosovës – Divizioni i Ankesave nr.389/2020 i datës 15.12.2020.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ në bazë të dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se, në seancë nuk ka prezantuar përfaqësuesi i autorizuar i palës së paditur, mirëpo me parashtrësën e datës 03.10.2024 e njëjta e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në seancë dhe ka kërkuar të veprohet konform nenit 38 paragrafi 5 të LKA-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 04.10.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: Certifikatë ARBK-së e e datës 20.03.2014 si dhe informatat mbi biznesin, Certifikatë nga ATK e datës 13.08.2019, Vendimi i ZGJONA me nr. 404/2020 e datës 30.09.2020, Njoftim vlerësimi e datës 01.10.2020, Raport i kontrollit e datës 30.09.2020, Paraqitja tabelare e zërave në deklaratat e tvsh sipas T/P për viti 2015 dhe për vitin 2016, Vendim 389/2020 e datës 15.12.2020, Katër formular i aprovimit të kërkesës për kompensimin e debi-kredi të T/P e datës 12.01.2021, Gjendja e borxheve e datës 16.11.2020, Marrëveshje e grantit e datës 06.08.2020 nr.1047, Ekspertizë financiare e datës 29.08.2024 dhe faturat e siguruar nga eksperti, Gjendja e borxheve e datës 22.07.2024, Përgjigje në padi 01.04.2022, Formular i deklarimit vjetor për: 2015 dhe 2016, Komunikim në mes të paditurës dhe DHTI i datës 04.08.2020, Intervista fillestare me T/P e datës 04.09.2020, Pasqyra e llogarisë bankare në Raiffeisen Bank, Kartela analitike, Faturat e shpenzimeve, Komunikimet e paditësit me të paditurën, Kërkesa për rimbursim e datës 28.12.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, konform dispozitave nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe erdhi në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se e paditura ka caktuar kontroll tek paditësi, me ç'rast objekti i kontrollit ka qenë tatimi mbi Vlerën e Shtuar për periudhën 01/2015 deri 12/2016, Tatimi në të Ardhurat të Korporatave për vitin 2015 dhe 2016, tatimi i Mbajtur në Burim dhe Kontributet Pensionale për periudhën 01/2015 deri 12/2016, ku si rezultat i këtij kontrolli paditësi është ngarkuar me detyrime shtesë tatimore për periudhën e kontrollit dhe atë: për TVSH tatimi shtesë në vlerë prej 16,472.27€ dhe ndëshkimi 4,118.06€, Tatim në të Ardhura të Korporatave CD 24,193.33€ dhe ndëshkimi 6,048.33€, tatimi në burim në interes 381.60€ me ndëshkim në vlerë prej 95.40€, Tatimi në Qira në vlerë prej 54.00€ dhe ndëshkim në vlerë prej 13.50€, ku vlera në total vlera e tatimit shtesë së bashku me ndëshkimet është 51,376.50€. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi ka ushtruar ankesë pranë departamentit të ankesave në ATK, e për të cilën ankesë ATK-ja me datë 15.12.2020 ka marr vendimin nr. prot. 389/2020, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar ankesën e këtij paditësit, e ndaj të cilit vendim paditësi me padinë e datës 18.02.2021 ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Gjykata në seancën e datës 10.05.2024 ka aprovuar propozimin e përfaqësuesit të paditësit nxjerrjen e provës përmes ekspertizës financiare dhe për ekspertë është caktuar I.T. me detyrat përkatëse sikurse në dispozitiv.

Në ekspertizën financiare të datës 29.08.2024 Eksperti financiar ka dhënë mendimin: pas sigurimit të faturave të blerjeve nga IPAKO dhe regjistrimi i tyre si blerje vendore me normën 18 % të TVSH, është rritur kreditimi nga blerjet me TVSH dhe si i rezultat ka ndryshime në obligimet tatimore në zërat e deklaratave të TVSH si dhe në Tatimin në të Ardhurat e Korporatave. Ekspertiza ka konstatuar se vlera totale e obligimeve tatimore është 8,508.48 euro.

Nga vendimi i kontestuar rezulton se ai përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. Në vendimin e kontestuar është dhënë arsyetimi sipas të cilit vlerësimi zyrtar i ATK-së është mbështetur në nenin 19 par.2 të Ligjit nr.03/L-222, mirëpo kjo për gjykatën nuk është e qëndrueshme, sepse e paditura as në vendimin e kontestues, por as në raportin e kontrollit nuk ka sqaruar se mbi bazën e cilave prova dhe informata konkrete paditësi është ngarkuar me

qarkullim dhe tatim shtesë. Gjykata vlerëson se nuk është i mjaftueshëm arsyetimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, se gjendja faktike është vërtetuar duke i marr për bazë: librat, regjistrimet, kuponët, faturat, ose informatat tjera përkatëse të tatimpaguesit, ose informatat nga personat e tretë, për arsye se nga raporti i kontrollit është konstatuar se në pozicionet e duhura të Librit të Blerjes dhe të Shitjes nuk shënohet asnjë nga elementet e librave, mungojnë numrat e faturave dhe nuk përkojnë në faturat e ofruara. Prandaj në raportin e kontrollit, vlerësimi tatimor është mbështetur në transaksionet bankare të cilat i ka ofruar paditësi.

Gjykata nga raporti i kontrollit konstaton se tatimi shtesë në TVSH ka rezultuar duke iu referuar transaksioneve bankare dhe harmonizimit të tyre me kartelën e IPKO-s, mirëpo nga inspektori tatimor janë njohur vetëm të hyrat në xhirollogari nga kjo kartelë dhe nuk janë njohur edhe shpenzimet në emër të faturave për IPKO-n. Prandaj gjykata konstaton se nga ana e inspektorit tatimor është bërë vlerësim i njëanshëm, kur në raportin e kontrollit është konstatuar se përcaktimi i të ardhurave sa i përket TVSH është bërë duke iu referuar transaksioneve bankare, ndërsa sa i përket blerjeve, për të njëjtat ka konsideruar se janë regjistruar në librin e blerjes, nuk i ka vlerësuar përmes transaksioneve bankare dhe nuk e ka njohur kreditimin e TVSH-së.

Gjykata ka analizuar edhe vlerësimin e raportit të kontrollit sa i përket blerjeve investive për periudhën 10/2015 dhe 12/2015, për të njëjtën kontratë të shitblerjes të datës 27.08.2015, një pjesë e pagesave janë pranuar si blerje e tatueshme, ndërsa për pjesën tjetër nuk është njohur e drejta e kreditimit të TVSH. Nga transaksionet bankare të datës 28.05.2015 në vlerë prej 35,000.00€, transaksioni bankar i datës 26.10.2015 në vlerë prej 50,000.00€, transaksioni bankar i datës 27.10.2015 në vlerë prej 60,000.00€, transaksioni bankar i datës 10.12.2015 në vlerë prej 20,000.00€, transaksioni bankar i datës 16.12.2015 në vlerë prej 20,000.00€, transaksioni bankar i datës 18.12.2015 në vlerë prej 15,000.00€, transaksioni bankar i datës 28.01.2016 në vlerë prej 14,000.00€ dhe transaksioni bankar i datës 29.01.2016 në vlerë prej 6,000.00€, gjykata konstaton se në përshkrimin e pagesës të gjitha këto transaksione e kanë të njëjtin përshkrim *“Pagese e lokalit sipas kontratës kati përdhese llamella, lokali nr.1 P-70403013-04947-2 e datës.27.08.2015 Giga Group ShPK”* dhe në të gjitha këto pagesa përfituesi i mjeteve është subjekti *“ICS-Clearing”*. Prandaj për gjykatën është i papranueshëm vlerësimi i të paditurës që për pagesat të cilat janë bërë për të njëjtin qëllim, të bëhen vlerësime të ndryshme, vetëm për faktin se paditësi nuk ka paraqitur fatura të blerjes, për faktin se i gjithë raporti i kontrollit është mbështetur në transaksione bankare dhe informacionet nga pala e tretë, prandaj e paditura edhe në këtë rast, ashtu siç ka vepruar me kartelën e IPKO-s është dashur të veproj edhe me kartelën

financiare të përfituesit të këtyre mjeteve në emër të lokalit “ICS-Clearing”. Gjithashtu, për të gjithë transferet dalëse në xhirollogarinë bankare që janë realizuar në emër të faturave, për përfitues të ndryshëm e paditura duhet t’i trajtoj ashtu siç ka vepruar me kartelën financiare të IPKO-s, më mënyrë që të bëhet vlerësimi i drejtë dhe i saktë i gjendjes financiar të biznesit të paditësit.

Gjithashtu gjykata ka shqyrtuar edhe bazën ligjore në të cilën është mbështetur e paditura kur ka përcaktuar interesin në huadhënie, UA 02/2016 neni 3 në të cilin parashihet se “*E ardhur nga interesi në huadhënie konsiderohet çdo e ardhur e përfituar nga dhënia në formën e huas të mjeteve monetare apo mjeteve të ngjashme me to. 3.1. Për këtë kategori të të ardhurave llogaritja e detyrimit tatimor bëhet duke u bazuar në kontratën në mes palëve e cila përcakton: 3.1.1. Shumën e huas; 3.1.2. Afatin e kthimit të huas; 3.1.3. Pranimi-kthimi i huas duhet të bëhet përmes llogarive bankare; 3.1.4. Shkallën e interesit të huas duke u bazuar në vlerën e hapur të tregut; 3.2. Nëse nuk plotësohen kushtet e parapara në nënparagrafin 3.1. të këtij neni, huaja për qëllime tatimore trajtohet e ardhur për pranuesin e saj.*” Gjykata konstaton se kjo bazë ligjore e përcakton interesin mbi huanë vetëm për kontratat e huasë të cilat lidhen me vullnetin e lirë të palëve me interes. Prandaj paragrafi 3.2 i nenit 7 të UA 02/2016, ndërlidhet me paragrafin 3 të po këtij neni i cili decidivisht përcakton interesin në huadhënie e jo formën e kontratës së huasë. Prandaj për gjykatën një vlerësim i tillë nga e paditura i mbështetur në këtë bazë ligjore nuk konsiderohet i pranueshëm në rastin konkret, kur kontratat e huasë në mes të paditësi dhe palëve tjera janë lidhur pa interes.

Të metat e lartcekura janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të deklarohet se mbi bazën e cilave prova konkrete e ka ngarkuar paditësin me detyrime tatimore për periudhën e kontrollit, si janë siguruar ato provat, çka vërtetohet me ato prova, kush i ka pranuar mjetet financiare në formë të transferit bankar në emër të faturave dhe blerjeve të pronave, dhe të njëjtat t’i bashkëngjiten shkresave të lëndës. E paditura në rivendosje obligohet të siguroj informata nga palët e treta, në rastin konkret nga subjektet pranuese të këtyre mjeteve dhe të vërtetoj faktin nëse këto subjekte i kanë regjistruar shitjet e realizuara nga paditësi në librat e shitjes. E paditura duhet të argumentojë edhe një herë saktë dhe qartë se si ka ardhur tek konstatimi sipas të cilit paditësi duhet të paguaj interes në huazime. Në ri procedurë e paditura të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t’i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43 par.2, dhe 46 par 1, 2 dhe 3, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti Fiskal
KF.nr.403/22, datë 04.10.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.